



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

22 Mars 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Në "Alo doktor" për një javë 1.382 thirrje



Në linjën telefonike 02/15 123 për këshillë mjekësore "Alo doktor" javën e kaluar (nga 14 mars deri më 20 mars) ka pasur 1.382 thirrje, kumtoi Shtëpia shëndetësore Shkup.

Nga 15 shtatori i vitit 2014 kur filloi të punojë linja telefonike, deri tani ka pasur 82.708 thirrje.

Linja është e arritshme çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim mjekësor i drejtpërdrejtë në momentin e paraqitjes së simptomave të ndryshme të

prishjes së shëndetit.

Njëzet e pesë mjekë janë të arritshëm për këshillë mjekësore, Thirrjet janë nga qytetarët e të gjitha qyteteve të Maqedonisë.

Thirrjet janë për spektrin e gjërë të simptomatologjisë më të ndryshme, më së shpeshti për shtypje të rritur të gjakur, kokëdhembje, ftohje sezonale, dhimbje simptomatike, temperaturë e rritur e trupit dhe këshilla lidhur me sëmundjet kronike.

Të gjithë atyre personave të cilët kanë kërkuar këshillë mjekësore në linjë telefonike "Alo doktor" u është dhënë ndihmë shëndetësore dhe terapi adekuate simptomatike.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Ose filtrat, ose të mbyllet Jugohromi



Për pak kohë sa është mbyllur, gjegjësisht për periudhë 3 mujore, në Tetovë dukshëm është reduktuar ndotja e ajrit nga substancat e dëmshme me një ulje drastike prej 55 për qind, thuhet në analizën "Politikat për uljen e ajrit të ndotur në Tetovë", e përgatitur nga shoqatat "AKVA" dhe "IKT për ndryshime"

Zejnulla VESELI

Kanë mbetur edhe pak ditë që fabrika "Jugohrom" në Tetovë sërish të startojë me punë, ndërsa informatat nga terreni tregojnë se nuk është realizuar asnjë aktivitet për vendosjen e filtrave si kusht i vetëm që përfundimisht kjo fabrikë të marrë lejen A të integruar për mbrojtjen e mjedisit.

Për pak kohë sa është mbyllur, gjegjësisht për periudhë 3 mujore, në Tetovë dukshëm është reduktuar ndotja e ajrit nga substancat e dëmshme me një ulje drastike prej 55 për qind, dallim kjo që nuk ishte që nga rihapja e fabrikës në korrik të vitit 2009. Kështu thuhet në analizën "Politikat për uljen e ajrit të ndotur në Tetovë", e përgatitur nga Shoqata për zhvillim dhe aktivizim "AKVA" nga Struga dhe shoqata "IKT për ndryshime" nga Tetova, në kuadër të projektit FISCAS, realizuar nga "Finance Think" dhe e përkrahur nga Ambasada Britanike në Shkup. Sipas kësaj analize, edhe pse si ndotës më i madh në Tetovë del të jetë "Jugohromi", e cila në njëfarë mënyre punon me 50 për qind të kapacitetit të saj të prodhimit, ajo sërish lëshon një sasi të madhe të grimcave të dëmshme në ajër. "Në dhjetor të vitit 2015, pas presionit të qytetarëve, pronarët e 'Jugohromit' vendosën të mbyllin procesin e prodhimit deri në fund të shkurtit.

Ndryshimi në cilësinë e ajrit ishte menjëherë i dukshëm. Pas mbylljes së fabrikës në dhjetor të vitit 2015, janari dhe shkurti i këtij viti kishte dallim të madh në cilësinë e ajrit. Madje, dallimi ishte i dukshëm që në ditët e para, menjëherë pas mbylljes së fabrikës", thuhet në këtë analizë. Si opsion i vetëm i mundshëm që më 1 prill të fillojë sërish me punë kjo fabrikë, sipas ekspertëve të kësaj analize, është vendosja e sistemeve për mbledhjen, gjegjësisht filtrimin e pluhurit, pavarësisht kostos së investimit, e cila është e njehershme. "Kostoja bie në kurriz të pronarëve të fabrikës, por përfitimet që ndodhin pas instalimit të sistemeve, janë shumë më të mëdha se kostot aktuale. Problemi i vetëm i këtij opsioni është që, rezultatet e para mund të



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



vërehen pas pesë vitesh nga zbatimi i planit operativ dhe ndikimi i përgjithshëm do të ishte në vitin e tetë", thuhet në këtë analizë. Gjithashtu, vlen të theksohet se në bazë të Ligjit për mjedisin jetësor, i miratuar në vitin 2005, "Jugohromi", është dashur të plotësojë kushtet për lejen e integruar mjedisore A jo më vonë se më 1 prill 2014. "Mirëpo, me vendim të Qeverisë, që njëherësh paraqet precedent në lidhje me objektet e tjera të mëdha industriale në Maqedoni, 'Jugohromit' i është vazhduar puna edhe për dy vjet në kundërshtim me ligjet. Duke pasur parasysh se edhe pas 11 vjetësh, 'Jugohromi' ka bërë disa përpjekje të mëdha për të zbatuar planin operativ dhe humbjet që ka bërë fabrika, mund të konstatohet se është e vështirë që deri në muajin prill në fabrikë të instalohet sistemi për filtrimin e plotë të ajrit vetëm për dy oxhaqe, ndërsa gjithsejtë ka 13 oxhaqe dhe të marrë lejen e integruar mjedisore A. Kjo mund të ndodhë vetëm nëse sërish i prolongohet afati për nisjen e punës", thuhet në këtë analizë. Megjithatë, edhe sikur të vendoset sistemi i filtrimit, ekspertët e kësaj e analizë konstatojnë se reduktimi i ndotjes së ajrit në Tetovë deri më 50 qind mund të ndodhë pas dhjetë viteve.

"Vetëm pas vitit të dhjetë të vendosjes së filtrave, ndotja e ajrit në Tetovë do të mund të reduktohet për 50 për qind nga kufiri i lejuar i PM grimcave nga sa lëshojnë vetëm dy oxhaqet, të cilat deri më sot kanë qenë në përdorim", thuhet në këtë analizë. Edhe François Schmitt, konsulent i kompanisë italiane "Intersil", firma e zgjedhur për vendosjen e filtrave në fabrikën "Jugohrom", shprehet se me realizimin e aktiviteteve të planit operativ për vendosjen e filtrave, "Jugohromi" do të reduktojë ndotjen e saj për 99.5 për qind vetëm pas 10 viteve.

"Pas përfundimit të aktiviteteve të planifikuara, 'Jugohromi' nuk do të jetë më një ndotës, që do të thotë se ndotja e ajrit në Tetovë do të reduktohet me 39.4 për qind, gjegjësisht përfitimet shëndetësore për njerëzit do të rriteshin gradualisht dhe atë në 7.9 për qind në vitin e parë, në vitin e dytë 11.8 për qind dhe në vitin e tretë 39.4 për qind, ndërsa pas vitit 10 - ajri do të reduktohet 99.5 për qind", thotë Schmit.

Pra, sipas ekspertëve të kësaj analize, vendosja e sistemit të filtrave është opsioni i vetëm pozitiv që fabrika të mund të vazhdojë me punë.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Brenda katër viteve u ulë çmimi i 4700 ilaçeve

Shkup, 21 mars – Janë zvogëluar çmimet e 4700 ilaçeve në katër vitet e kaluara. Këtë veprim, VMRO-DPMNE e quan si një nga reformat e thella nga sfera e shëndetësisë.

Ashtu siç theksoi drejtori i Fondit Sasho Stefanovski në mbledhjen e fundit të kësaj partie ku u prezantua raporti i punës 10 vjeçare, përmes kësaj mase sistematike u ulen çmimet për disa herë, duke i bërë të kapshme për qytetarët.

“Sistemi i shëndetësisë kurseu 33 milion euro, që i investoi në rinovime, por edhe dy masat e tjera që ndihmuan edhe në centralizimin e furnizimit të barnave. 43 milion euro kursime në këto vite të cilat i shfrytëzoi shumë më reacionalisht, tha Stefanovski.



Nataliteti në vend, kërkohet rimodelimi i programit



Në Maqedoni gjithnjë e më pak lindin fëmijë, kështu tregojnë statistikat zyrtare. Në vitin 2014, janë lindur 20,890 fëmijë, që është 6871 më pak se në vitin 2002. Hulumtimet tregojnë se subvencionet për fëmijë të tretë nuk kanë efekt mbi normën e përgjithshëm të rritjes natyrore të popullsisë, përveç në vitin 2009, kur paguheshin shtesa për fëmijën e dytë dhe të katërt.

“Programi për subvencionim të fëmijës së tretë shumë vështirë justifikohet në aspektin e shpenzimeve aktuale që bëhen duke pasur parasysh se nuk kemi rritje drastike të natalitetit në vend”, deklaroi Dimitar Nikollovski, profesor universitar.

Që nga viti 2009, kur filluan subvencionet, rritet numri i lindjes së fëmijëve të tretë. Sipas të dhënave, në vitin 2014, janë lindur 3366 fëmijë të tretë, ndërsa në vitin 2009 ka pasur 2634. Para kësaj numri i fëmijëve të tretë ka qenë vazhdimisht në rënie.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË


www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Megjithatë, paralelisht me rritjen e lindjes së fëmijëve të tretë, zvogëlohet numri i lindjes së fëmijëve të parë dhe të dytë. Në vitin 2014 kanë lindur 3.196 fëmijë të parë më pak se në vitin 2002 derisa në vitin 2014 kanë lindur 1.835 fëmijë të dytë më pak se në vitin 2002. Kjo është arsyeja pse ekonomistët konsiderojnë se masa duhet rimodeluar, por sipas tyre, gjëja më e rëndësishme është të krijohet mjedis më i mirë ekonomik që do ti motivonte natyrshëm familjet të kenë fëmijën e parë dhe të dytë.

Tuberkuloza shënon rënie në Maqedoni nga viti në vit



Sipas statistikave më të reja, në vitin 2015 janë hasur 284 raste me sëmundjen e tuberkulozës, që është për një më pak se vitin paraprak, transmeton Telegrafi Maqedoni.

Numri i vdekjeve në vitin e kaluar arriti në 18, ngjashëm si viti 2014. Përqindja e tuberkulozës te fëmijët është ulur në 14 raste, në krahasim me vitin 2014, kur u diagnostifikuan 19 raste.


Rastet me tuberkulozë janë të moshave të ndryshme, nga nxënësit e shkollave fillore e deri te studentët, kurse rastet me këtë sëmundje, nga viti në vit shënojnë rënie, po ashtu edhe vdekshmëria.

Drejtoresha e Institutit për Tuberkulozë, Biljana Ilievska-Poposka, thotë se që nga viti 2002, në Maqedoni bie numri i të sëmurëve nga tuberkuloza.



Në "Alo doktor" për një javë 1.382 thirrje

Në linjën telefonike 02/15 123 për këshillë mjekësore "Alo doktor" javën e kaluar (nga 14 mars deri më 20 mars) ka pasur 1.382 thirrje, kumtoi Shtëpia shëndetësore Shkup...



Nga 15 shtatori i vitit 2014 kur filloi të punojë linja telefonike, deri tani ka pasur 82.708 thirrje.

Linja është e arritshme çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim mjekësor i drejtpërdrejtë në momentin e paraqitjes së simptomave të ndryshme të prishjes së shëndetit.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Njëzet e pesë mjekë janë të arritshëm për këshillë mjekësore, Thirrjet janë nga qytetarët e të gjitha qyteteve të Maqedonisë.

Thirrjet janë për spektrin e gjërë të simptomatologjisë më të ndryshme, më së shpeshti për shtypje të rritur të gjakur, kokëdhembje, ftohje sezonale, dhimbje simptomatike, temperaturë e rritur e trupit dhe këshilla lidhur me sëmundjet kronike.

Të gjithë atyre personave të cilët kanë kërkuar këshillë mjekësore në linjë telefonike "Alo doktor" u është dhënë ndihmë shëndetësore dhe terapi adekuate simptomatike./Mia

Prindërit: fëmijët me sindromën "Daun" janë në mesin tonë

Fëmijët e prekur nga sindroma "Daun" dhe sëmundje të rralla janë në mesin tonë, prandaj është koha që t'i pranojmë si pjesë e shoqërisë...



Kështu deklaruan me rastin e 21 marsit, Ditës Botërore të Fëmijëve me sindromën "Daun", si dhe prindërit e këtyre fëmijëve, duke paralajmëruar fushatën "Zgjimi".

"Si nënë e fëmijës me nevoja të veçanta nuk dua të ndjeni keqardhje apo ta pranoni këtë se jemi këtu për t'i treguar fëmijët. Dëshiroj t'i pranoni fëmijët me nevoja të veçanta, sepse ata sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat si fëmijët e tjerë"- tha nëna e fëmijës me sindromën

"Daun", Ançe Tufekxhieva.

"Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta janë kategori e veçantë e njerëzve. Ata gjithmonë dinë gjithçka. Dinë ta njohin dhimbjen, dinë të gëzohen në lëvizjet e vogla të fëmijëve të tyre dhe fëmijëve tjerë. Ata gjithmonë patjetër të dinë gjithçka dhe të jenë të përgatitur disa hapa para faktorëve të tjerë që janë të përfshirë në jetën e fëmijëve të tyre dhe ngritjen e tyre"- theksoi nëna e fëmijës me sëmundje të rrallë, Daniela Mirçeska.

Një nga 700 fëmijë lind me sindromën "Daun", prandaj prindërit theksojnë nevojën që në çerdhe dhe shkolla të ketë të punësuar defektologë dhe psikologë që do t'u ndihmonin fëmijëve me nevoja të veçanta.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Sot është Dita botërore e Ujit



Në organizim të Institutit për shëndet publik sot do të shënohet Dita botërore e ujit 2016, dedikuar Ujit dhe vendeve të punës.

Shënimi i Ditës botërore të ujit në Maqedoni organizohet për herë të nëntë me qëllim që të ngritet vetëdija te popullata në përgjithësi për rëndësinë e ujit për shëndetin e njeriut.

Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara më shumë se 3,6 milionë njerëz çdo vit vdesin nga sëmundjet e lidhura me ujin në mjediset joekologjike. Çdo ditë 38 të punësuar vdesin nga sëmundjet e shkaktuara nga uji. Në Afrikën SubSahariane, gratë dhe vajzat çdo ditë shfrytëzojnë rreth 25 për qind të kohës për furnizimin e ujit. Më shumë se 1/3 e shkollave në vendet në zhvillim nuk kanë qasje deri te uji i pastër për pirje dhe për higjienë.

Rastet e vdekjes mund të parandalohen me ujë më të mirë dhe sanim.

Sot rreth gjysma e punëtorëve në botë, 1,5 miliardë njerëz punojnë në sektorë lidhur me ujin dhe pothuajse të gjitha punët varen nga uji ose janë të lidhura me dorëzimin e tij. Megjithatë, miliona njerëz puna e të cilëve është e lidhur drejtpërdrejtë me ujin e pastër nuk i gëzojnë të drejtat punëtoare. Tema për këtë vit është “Uji dhe vendet e punës”, ndërsa qëllimi është që të tregohet se sasi të e mjaftueshme të ujit dhe uji cilësor mund ta ndryshojnë jetën dhe ekzistencën e punëtorëve dhe madje edhe të transformojë shoqëri dhe ekonomi.

Është vlerësuar se në vitin 2014, rreth 37 për qind e popullatës, ose rreth 770.000 njerëz, në Republikën e Maqedonisë jetojnë në 1.420 vendet të banuara rurale. Rreth 27 për qind nga popullata rurale janë të lidhur në sistemet urbane të ujësjellësit, të menaxhuara profesionalisht nga 56 ndërmarrje publike komunale. Rreth 62 për qind e banorëve rural furnizohen me ujë nga sistemet e vogla të ujit në lagjet e fshatrave varësisht nga objektet lokale të furnizimit me ujë (bunare, pompa, çezma të fshatit, pusët).



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Problemet e përbashkëta të cilat ndikojnë në cilësinë e ujit për pirje në sistemet e vogla të ujit janë mungesën e zonave mbrojtëse dhe gardheve, rrjeti i vjetërsuar dhe i dëmtuar i ujit, kloirimi jo i rregullt i ujit për pirje dhe pastrimi jo i përshtatshëm i ujit.

Në kuadër të shënimit të Ditës botërore të ujit do të mbahet tribunë në temë “Të mësojmë ta kursejmë ujin”, në të cilën do të bëhet kontroll i shkurtër i pikëpyetjeve të ndara midis fëmijëve dhe nxënësve nga kopshti Spirit dhe SHF “Johan Hajnrik Pestaloci”. Qëllimi ishte të merren informacione sa ata janë të informuar për ujin në përgjithësi, rëndësia e tij dhe për situatën në Afrikë, si kontinent i cili ende ka problem me qasjen e ujit të sigurt për pirje.